



**IEKA** Instituti i Eksperteve  
Kontabel të Autorizuar

**Eleda Dhima** Auditues Ligjor  
Licenca profesionale Nr.197, datë 30.01.2009

---

# **RAPORT I MONITORIMIT TE FUSHATES ZGJEDHORE 2019**

## **PARTIA EMIGRACIONI SHQIPTAR**

**Pala Angazhuese: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Pala Përgjegjëse: PARTIA EMIGRACIONI SHQIPTAR**

# **RAPORTI I MONITORIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE**

## **I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

### **INFORMACIONI LIGJOR**

i. Kuadri ligjor mbi të cilin jam mbështetur për përparatjen e raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pushtetit vendor është:

- Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,
- Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017,
- Udhëzimi i KQZ-së, Nr. 1, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",
- Udhëzimi i KQZ-së, Nr.2 datë 01.06.2017 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përparatjen dhe emërimin e ekspertëve financiarë"
- Udhëzimi i KQZ-së, Nr.3 datë 2.06.2017 "Për përparatjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të perdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".
- Vendimi i KQZ-së nr 152 datë 11.04.2019 "Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara e të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara ete shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore"

ii. Kontrata e shërbimit

iii. Vendimi i KQZ-së

iv. Përgjegjësitë respektive të palëve, subjektit zgjedhor dhe ekspertit financiar/monitoruesit

### **Angazhimi, Objekti dhe Qëllimi**

Në cilësinë e ekspertit financiar, jam angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në misionin e monitorimit të shpenzimeve të fushatës zgjedhore 2019 të Partisë Emigracioni Shqiptar në bazë të vendimit të KQZ nr 740 datë 30.05.2019 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019".

Qëllimi i monitorimit është mbledhja e informacionit mbi të ardhurat dhe shpenzimet në procesin e kryerjes së fushatës që zhvillon Partia Emigracioni Shqiptar në gjithë territorin e vendit, dhe analiza e tij për të vlerësuar shkallën e pajtueshmërisë së realizimit të fushatës zgjedhore të subjektit me kërkesat e akteve ligjore e nenligjore zgjedhore, kryesisht në aspektin financiar.

Pra, përveç gjetjes dhe raportimit të fakteve qëllimi i monitorimit është dhe vleresimi i tyre nëse janë në pajtueshëri me kërkesat të legjislacionit zgjedhor.

Në mënyrë të sintetizuar objektivat e monitorimit janë dhënë në Udhëzimet e KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiarë”, e nr 8, datë 25.03.2009 “Për miratimin e kritereve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore”, i ndryshuar.

sipas tyre ekspertët financiar të emëruar sipas këtij udhëzimi duhet të monitorojnë në mënyrë specifike:

- a) Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 date 22.05.2017.
- b) Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;
- c) Respektimin e kufirit maksimal të shpenzimeve dhe të kufizimeve sipas llojit, sidomos përsa i përket materialeve propagandistike dhe reklamave televizive;
- d) Kostimin e veprimtarive të monitoruara me qëllim krahasimin e mëvonshëm me shpenzimet e deklaruara nga subjekti zgjedhor gjatë raportimit;
- e) Rregullat e brendëshme të subjektit elektoral për raportimin e shpenzimeve;
- f) Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Në tërësi monitorimi përfshin vezhgimin e mbledhjen informacioneve financiare dhe jo-financiare që lidhen me zbatimin e dispozitave ndaluese dhe kufizuese nga subjekti zgjedhor gjatë zhvillimit të fushatës por dhe ato financiare të shprehura specifikisht në udhëzimin e sipercituar.

740 date 30.05.2019

“Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve financiarë dhe audituesve ligjorë të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019”. KQZ vendosi të emërojë audituesit ligjorë, të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Periudha e kryerjes së monitorimit të procesit zgjedhor, për të cilën do të behet matja dhe vleresimi, fillon me nënshkrimin e kontratës datë 06.06.2019, dhe mbaron në datën 16.10.2019, 3 muaj pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve. Por gjithashtu pjesë e monitorimit do të jetë dhe periudha para lidhjes së kontratës, tre muaj para datës së zgjedhjeve për transaksionet e kryera në shërbim të fushatës zgjedhore të subjektit.

## **Metodologjia e monitorimit**

Për të siguruar evidencën e nevojshme dhe të pershtatëshme të monitorimit, përveç përgatitjes së programit, ne kemi përcaktuar gjithashtu dhe metodologjinë e monitorimit, metodat dhe procedurat e sigurimit të saj, të përshkruara në vijim.

### Kerkesa për informacion nga subjekti zgjedhor

Procesi monitorimit filloj pa patur më parë një bazë raportuese të dhënash rreth fushates zgjedhore (projektin e hartuar nga partia) dhe rrjedhimisht pas marrjes së angazhimit i është kërkuar Partise Emigracioni Shqiptar, si palë përgjegjëse, të raportojë informacionin e nevojshëm rreth organizimit të fushatës dhe konkretisht për:

- Lista e zyrave elektorale dhe adresat e tyre ne te gjitha bashkite.
- Lista e aktiviteteve, vendet dhe datat e zhvillimit te tyre.
- Listen e bashkive të njoftuara nga Partia për hapjen e zyrave elektorale.
- Kontrata me entitete tregtare per blerje mallrash e sherbimesh

### Konfirmime nga të tretët

Gjithashtu, duke qenë se Bashkitë kanë detyrimin ligjor për verifikimin në terren të vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të udhëzimit të KQZ-se për afishimin e materialeve propagandistike, ne i kërkuam Bashkive informacionin për zbatimin e detyrimeve që ato kanë.

### Të tjera procedura kryesore për monitorim

Ne varësi të natyres së çështjeve, përveç sa me sipër, për sigurimin e evidences se nevojshme, u përdorën këto procedura e vëzhgimit, inspektimit, rillogaritja, metoda vleresimi, etj,

### Zgjedhje e elementeve për monitorim

Në përshtatje me kohën që patëm në dispozicion dhe numrit të madh të elementeve të fushates, monitorimi është programuar të realizohet mbi baze kapioni. Madhesia e kapionit është mbështetur në nivelin e rrezikut të vlerësuar dhe përzgjedhja e elementeve për tu testuar bazonet në metoden statistikore, e cila nënkupton se kampioni zgjidhet në mënyrë rastësore dhe për vlerësimin e rezultateve të kampionit përdoret teoria e probabilitetit. Ne disa raste të vecanta është përdorur dhe gjykimi profesional.

### Mënyrat e marrjes dhe dokumentimit të gjetjeve nga grupi angazhimit

Ne procesin normal të monitorimit të një zyre elektorale, nepermjet vëzhgimit dhe inspektimit, ne kemi ndjekur një procedure standarde e cila përfshin: prezantimin si ekspert financiar, shpjegimin për qëllimet e monitorimit, prezantimin e detyrimeve ligjore që ka subjekti, kërkimin e informacionit për përdorimin e ambjenteve, marrjen e lejes për të fotografuar ambientet e jashtme dhe realizimi i saj.

Ndërsa për aktivitetet grupi angazhimit indentifikon dhe fotografon elementët e mundëshëm të kostove që duhen për zhvillimin e aktivitetit, llojet dhe sasite e përfaqëta të inventareve dhe

materialeve publicitare dhe kur eshte e mundur u kerkohe organizatoreve faturat e blerjeve të mallrave e sherbimeve për aktivitetin konkret.

#### Analiza dhe sinteza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit, por edhe ato të siguruar nga raportimet, financiare dhe jo financiare analizohen në tërësi e tyre për pajtushmerine me kriteret ligjore apo kriteret e tjera, për të arritur në konkluzionet përfundimtare.

### **Pergjegjesite dhe Kufizimet**

Ky angazhim është një marreveshje tri palëshe që përfshin ekspertët financiar palën përgjegjëse (Partine Emigracioni Shqiptar) dhe palën angazhuese (KQZ-në) dhe ka elementet e duhur të një angazhimi për dhenie sigurie.

Përgjegjësia e palës përgjegjëse është që të zhvillojë fushatën zgjedhore në përputhje me legjislacionin zgjedhor, legjislacionin tatimor, ligjin për pasqyrat financiare dhe standardet kontabël etj

Përgjegjësia e ekspertëve është kryerja e monitorimit në përputhje me standardet profesionale të cilat kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike, të planifikojmë dhe kryejmë angazhimin me qellim që të arrije të marrë siguri të arsyeshme ose siguri të kufizuar në varësi të çështjes konkrete.

Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një monitorimi, së bashku me kufizimet e qe sjell testimi mbi mbi bazen e kampionit, ekziston një rrezik i pamënjanueshëm që disa nga anomalitë të mbeten të pazbuluara, edhe pse monitorimi është planifikuar siç duhet dhe kryer në përputhje me standardet profesionale.

Siç e kemi prezantuar dhe në raportet e ndërmjetme, evidenca që kemi parashikuar të sigurojme me këtë proces, mbështetur dhe në udhëzimet e KQZ-së, janë marrja e informacioneve për:

- Numrit të zyrave zgjedhore për një lagje ose fshat, për të bërë kontrollin e zbatimit të rregullit që dikton subjektet zgjedhore të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat.
- Madhësi të zyrave elektorale, për të bërë përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që përdoren për qëllime zgjedhore.
- Materialeve propagandistike të përdorura, me qëllim kontrollin e llojeve të materialeve që janë objekt kufizimi dhe për qëllime të përlogaritjes së shpenzimeve.
- Vendosjes së materialeve propagandistike, për të kontrolluar përdorimin dhe afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor.
- Dokumentave të përdorimit të zyres për të gjetur burimin e financimit, kontrate qeraje apo donacion nga simpatizantët.

### **Pra siç duket dhe nga objektivat e vendosura pritet të realizohen tre qellime kryesore:**

- Kontrollin e respektimit të kufizimeve të kërkuara nga udhezimi i KQZ-se për vendosjen në teritor të zyrave elektorale, një zyrë zgjedhore për një lagje ose fshat,
- Kontrollin kufizimeve të kërkuara nga udhezimi i KQZ-se për respektimin e distancës në vendosjen e materialeve publicitare pranë zyrave elektorale dhe,
- Kontrollin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore, pasi çdo shpenzim jashtë kriterëve të mësipërme konsiderohet shpenzim në kundërshtim me pikën 4 të nenit 24/2 të ligjit nr. 90/2017

Per realizimin e saj, grupi i angazhimit ka përdorur **procedurën e vëzhgimit dhe inspektimit i zyrave** në terren dhe **konfirmimet nga bashkitë**, si institucione që kanë rol kontrollues për këto çështje.

### **B. PARAQITJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT DHE STRUKTURA E TIJ**

- i. Prezantimi i subjektit zgjedhor
- ii. Struktura dhe objekti i raportit të monitorimit
  - a. Zyrat zgjedhore
  - b. Aktivitetet, eventet dhe materialet e fushatës
  - c. Vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore nga ana e subjektit zgjedhor
- iii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundëshme midis ekspertit financiar dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.
- iv. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e monitorimit.

Partia Emigracioni Shqiptar është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me urdhër nr. 66 datë 20.03.2017 të Ministrit të Drejtësisë. Kryetar i saj është zoti Kostaq Papa i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të partisë. Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj. Subjekti zgjedhor Partia Emigracioni Shqiptarë është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë. Adresa e Partisë Emigracioni Shqiptar është në Lagjen Ali Demi, pallati 157, shk 2 kati 1, Tiranë. Gjatë periudhës së funksionimit normal të partisë kryerja e punëve të përditëshme mbështetet në punën vullnetare të antarëve dhe simpatizantëve të saj, ajo nuk ka të punësuar të regjistruar. Sistemi kontabel është i organizuar në qender dhe mbajtja e llogarive realizohet nga vullnetarë. Kjo situatë ka vazhduar edhe gjatë zhvillimit të fushatës dhe nuk ka shtesë të punësuarish.

Kriteret e monitorimit, kundrejt të cilëve do të vlerësohet dhe matet shkalla e përputhshmërisë së fushatës zgjedhore me aktet ligjore dhe rregullative burojnë nga: Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017, Udhëzimin e KQZ-së, Nr. 1, datë 31.05.2017, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", Udhëzimin e KQZ-së,

Nr.2 date 01.06.2017 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiar“Udhëzimin e KQZ-së, Nr.3 date 2.06.2017 "Për përlogaritjen e kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të perdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore".Ligjin për kontabilitetin dhe standardet kontabël përkatëse,etj.

Një përshkrim i hollësishemi kriterëve vleresuese specifike është dhënë para konkluzioneve të çdo çështje të monitoruar e të shqyrtuar.

Me date 07.06.2019 pas nënshkrimit të kontratës me KQZ-ne kam komunikuar me kryetarin e Partisë së Emigracionit Shqiptar zotin Kostaq Papa për kërkuar informacion për fushatën zgjedhore që kishte filluar. Nga komunikimi me zotin Kostaq u sqarova se kjo parti kishte listë me anetare për keshillin në bashkitë Gramsh e Kelcyre dhe kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Kelcyre. Për programin e fushatës ishte duke u punuar për të përgatitur një program të përbashkët sepse po presnin të krijohej koalicioni "Shpresa për ndryshim" pasi nuk kanë marrë vendime për organizim takimesh elektorale.

Për të marrë informacion për zyrat elektorale kam dërguar leter rekomande për Bashkinë Gramsh e Bashkinë Kelcyre në mënyrë që të vazhdoj monitorimin. Me shkresën nr 3791/1 date 11.06.2019 Bashkia Gramsh më informon se nuk ka zyra elektorale në teritorin e kësaj Bashkie për Partinë e Emigracionit Shqiptar.Po kështu edhe Bashkia Kelcyre më shkresën nr 1318 date 11.06.2019 më informon se nuk ka zyra elektorale në teritorin e kësaj Bashkie për Partinë e Emigracionit Shqiptar.(shkresat bashkelidhur raportit)

Nga komunikimet me Partinë e Emigracionit Shqiptar kam marrë prej saj programin e për fushatën elektorale. Kjo parti nuk ka zyra elektorale dhe takimet me elektoratin i ka planifikuar që të kryej në ambiente të anetareve të partisë si bar kafe ose në ambiente të hapura. Kjo parti ka mundësi të kufizuara për organizime të mëdha edhe për shkak përhapjes së saj jo në të gjithë teritorin e vendit me strukturë të saj si dhe të mundësive të pakta ekonomike. Sipas programit elektoral takimet elektorale me lagje e fshatra do të jenë masive nga data 16 e në vazhdim. Sipas programit elektoral të Partisë së Emigracionit shqiptar për datat 17.06.2019- 28.06.2019 takimet elektorale me lagje e fshatra u planifikuan me fshatra ose lagje kryesisht për qytet Gramsh e Kelcyre. Takimet kanë qenë në grupe të vogla sipas planifikimit, të zhvilluara kryesisht në ambiente bar kafe apo ambiente të hapura.

## **II. PËRMBLEDHJE / KËRKESAT FORMALE**

### **A. PËRMBLEDHJE**

<b>1/ Identifikimi i subjektit zgjedhor në raportin e monitorimit</b>		
a) identifikimi i subjektit zgjedhor (partia, kandidati/ja)	Po / Jo	Partia Emigracioni Shqiptar
b) identiteti i personit përgjegjës për financat	Po / Jo	Kostaq Papa

	c) evidenca e çeljes së llogarisë bankare	Po / Jo	Nuk ka
	d) paraqitja e deklarimeve bankare që mbulojnë periudhën e fushatës	Po / Jo	Nuk ka
<b>2/ Nënshkrimi dhe data e paraqitjes së raportit të monitorimit</b>			
	Eksperti financiar	Po / Jo	Eleda Dhima
	Nënshkrimi	Po / Jo	Datë
	Dorëzimi i raportit të monitorimit	Po / Jo	21.11.2019
<b>3/ Aktivitetet, eventet dhe materialet e monitoruara</b>			
	a) Zyrat zgjedhore	Po / Jo	Nuk ka
	b) Respektimi i ndalimit të aktiviteteve zgjedhore edhe nga ana e bashkive.	Po / Jo	<i>Parregullsitë që duhen përmendur dhe që duhen evidentuar më vonë</i>
	c) aktivitetet	Po / Jo	10
	d) eventet		Nuk ka pasur
	e) materialet propagandistike		Numri i monitoruar

## B. ANALIZA

### a/ Kërkesat formale

#### - Llogari bankare e veçantë

- A është hapur llogaria vetëm për fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacione që e kalojnë shumën prej 100,000 Lekë?

Subjekti ka hapur një llogari bankare në emër të Partisë së Emigracionit Shqiptar me datë 13.06.2019 në Bankën Raiffeisen me IBAN AL44202110060000000001402199.

- Evidenca e hapjes së llogarisë bankare (data, dokumenti nga banka)?
- Paraqitja e deklarimeve bankare që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore? Në llogarinë bankare ka vetëm komisionet mujore për mirëmbajtjen e llogarisë.
- Kush është personi përgjegjës i financave? Personi përgjegjës për financat është vetë kryetari i Partisë së Emigracionit Shqiptar zoti Kostaq Papa.

#### - Procedura verifikimi

- Shkëmbim informacioni ndërmjet personit përgjegjës për financat/ partinë/ kandidatin/ çdo person fizik apo juridik

Nga komunikimet me persona të angazhuar në fushatë nga Partia e Emigracionit Shqiptar si Erald Latifi, Gramoz Mamo, Hazbi Kasaj, Isuf



Isufaj, Aurel Muho, Maliq Goxhaj, etj kam konstatuar se nuk ka zyre elektorale, por zhvillojne takime ne ambiente te hapura ose ne bar kafe te ndryshme

- o Informacioni i dhënë nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dhe palët e treta Nga informacionet e mara nga palet e treta konstatova se nuk ka parregullsi ne aktivitetin e kesaj partie.
- o Denoncimet/ ankesat e mbërritura në KQZ  
Nuk ka denoncime e ankesa ndaj kesaj partie te mberritura ne KQZ.

### 1. Listat e kontrollit/ Tabela e raportimit

Partia Emigracionit Shqiptar ka paqitur kandidat per kryetar bashkie ne Bashkine Kelcyre dhe lista me kandidate per anetar te keshillit bashkiak vetem ne bashkine Gramsh e ne Bashkine Kelcyre. Kjo parti nuk ka pasur zyra elektorale as ne bashkite ku ka pasur liste per anetar te keshillit bashkiak.

Te gjitha aktivitetet e kryera nga anetaret e partise dhe simpatizantet e saj jane kryer ne biseda familjare me te njohur dhe ne raste te vecanta ne lokale tendryshme si ne Tirane, Laprake, Kamez, Kelcyre e Gramsh. Ato do të përdoren për të gjeneruar i) gjetje për raportet javore të dorëzuara në KQZ dhe ii) për të bërë një përmbledhje të konsoliduar të gjetjeve të monitorimit.

#### Lista1: Zyrat elektorale

Bashkia	Kelcyre
Adresa	Kelcyre
Data dhe koha e vzhgimit	24.06.2019; Ora 17:45
Madhesia e zyrës elektorale	Nuk ka
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore") Marrveshje qiraje	Ne pergjigje te Bashkise Klecyre me nr. 1318 prot, date 11.06.2019 rezulton se Partia Emigracioni Shqiptar nuk ka zyre elektorale ne territorin e Bashkise Kelcyre.
Numri i stafit te vzhguesve	
Pajisjet e verejtura	Nuk ka
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	

Bashkia	Gramsh
Adresa	Gramsh
Data dhe koha e vzhgimit	27.06.2019; Ora 18:00
Madhesia e zyrës elektorale	Nuk ka

Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore") Marrveshje qiraje	Ne pergjigje te Bashkise Gramsh me nr. 3791/1 prot, date 11.06.2019 rezulton se Partia Emigracioni Shqiptar nuk ka zyre elektorale ne territorin e Bashkise Gramsh.
Numri i stafit te vezhguesve	
Pajisjet e verejtura	Nuk ka
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	

Bashkia	Tirane
Adresa	Ali Demi, pallati 157, shk 2 kati 1, Tiranë
Data dhe koha e vezhgimit	26.06.2019; Ora 19:30
Madhesia e zyres elektorale	
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore") Marrveshje qiraje	
Numri i stafit te vezhguesve	
Pajisjet e verejtura	
Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	

Bashkia	Kamez
Adresa	Kamez
Data dhe koha e vezhgimit	26.06.2019; Ora 18:10
Madhesia e zyres elektorale	Pa percaktuar
Deklarata e bashkisë (brenda 5 ditëve në pajtim me Udhëzimet nr. 1, datë 31.05.2017 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore") Marrveshje qiraje	
Numri i stafit te vezhguesve	
Pajisjet e verejtura	

Vlerësimi i kostos së zyrës elektorale për periudhën e monitorimit	

## **Lista 2: Materiale propagandistike të fushatës zgjedhore të ndaluara (palejuara)**

### **Raportimi javor**

Nga shqyrtimi i informacionit të monitorimit të zyrave gjetjet dhe konstatimet domethënëse janë:

- Nga zyrat e monitoruara nuk u evidentua asnjë rast që materialet prapagandistike të ishin vendosur mbi perimetrin e 5 metrave te kufizimit te zyrave elektorale.
- Gjatë vezhgimit dhe inspektimit të zyrat elektorale,bazuar ne informacionin e marre nga partia qe tregonin vendndodhjen e tyre, sipas gjykimit të grupeve te monitorimit nuk u gjenden me shume se nje zyre elektorale ne lagjet dhe fshatrat që qenë objekt monitorimi.Por kjo pritet të konfirmohet nga pergjigjet apo e bashkive.
- Ne te gjitha rastet e monitoruara,nga informacioni i qe eshte marre nga personat përgjegjes të zyrave, perdorimi i zyrave ishte kryesisht nga donacione te simpatizanteve dhe jo ne kontrata qeraje. Kjo pike do te vazdoje te jete ne fokusin tonë dhe ne fazat e tjera monitorimit te dokumentacionit.
- Per të gjitha zyrat elektorale të monitoruara u evidentuan në mënyrë të perafert siperfaqet ne perdorim dhe materialeve propagandistike reklamuar prane tyre,të dhena që do të sherbejne në përlllogaritjen e kostove.
- Sipas programit elektorale te Partise se Emigracionit shqiptar per datat 24.06.2019-28.06.2019 takimet elektorale me lagje e fshatra u planifikuan per qytet Gramsh, Kelcyre, Kamez e Laprake. Ne takimet me zotin Kostaq Papa, Kryetar i Partise se Emigracionit Shqiptar, per programin elektorale u sqaruam se puna e anetareve dhe e simpatizanteve te kesaj partie do te behej ne grupe te vogla. Per mungese te te ardhurave kjo parti nuk mundi te hape zyra elektorale qe te kishim mundesisne e verifikimve te tyre. Nisur nga te dhenat qe na u mundesuan nga zoti Kostaq Papa, pasi kishim folur ne telefon me zotin Erald Latifi ne qytetin e Gramshit dhe me zotin Hazbi Kasaj ne Kelcyre per datat e oren e takimeve shkova ne keto qytete.

Bashkia	Kelcyre
Data dhe koha e vezhgimit	-
Vendosja e materialeve propagandistike më shumë se 5 metra nga zyra zgjedhore	Nuk ka-
Materialet e verejtura	Nuk ka
Fotografite e marra	-

Tipi	Vendndodhja	Numri	Kostoja e parashikuar
Postera, flamuj, etj	-	Nuk ka	-

### Lista 3: Aktivitetet e fushatës

BASHKIA		KELCYRE	
Data dhe koha e vezhgimit		24/06/2019; Ora 17:45	
Vendosja e materialve propagandistike me shume se 5 metra nga zyra zgjedhore		JO	
Materialet e verejtura		Logo e partise	
Fotografi te marra		PO	
Tipi	Vendndodhja	Numri	Kostoja e parashikuar
Postera, logo	Kelcyre	2	0
Partia/Kandidati		Partia Emigracioni Shqiptar / Hazbi Kasaj	
Lloj i eventit		Takim i fushates elektorale	
Vendi dhe koha e fushates		Ambjent i jashtem i lokalit, Kelcyre	
Vendtakimi per fushaten zgjedhore		Kelcyre	Ora 17:45

Shenim: Nuk u verejten materiale te fushates se ndaluar.

Madhesia dhe kapaciteti i vendit	Pa percaktuar
Numri i pjesmarresve	4-8
Stafi organizues	Stafi i partise dhe vullnetare
Pije dhe ushqim i ofruar	Nuk ka
Argetim	Nuk ka
Transporti	I te ftuarve, materialeve dhe zyrtareve te partise
Sistemi audio	Nuk ka
Dhurata promocionale	Nuk ka
Shenime: Ne takim me qytetaret ishte kandidati i PESH zoti Hazbi Kasaj	

BASHKIA	Gramsh
Data dhe koha e vezhgimit	27/06/2019; Ora 18:00

Vendosja e materialve propagandistike me shume se 5 metra nga zyra zgjedhore		JO	
Materialet e verejtura		Logo e partise	
Fotografi te marra		PO	
Tipi	Vendndodhja	Numri	Kostoja e parashikuar
Postera, logo	Gramsh		

Partia/Kandidati		Partia Emigracioni Shqiptar	
Lloj i eventit		Takim i fushates elektorale	
Vendi dhe koha e fushates		Ambjent i jashtem i lokalit, Gramsh	
Vendtakimi per fushaten zgjedhore		Gramsh	Ora 18:00
Madhesia dhe kapaciteti i vendit		Pa percaktuar	
Numri i pjesmarresve		6-7	
Stafi organizues		Stafi i partise dhe vullnetare	
Pije dhe ushqim i ofruar		Nuk ka	
Argetim		Nuk ka	
Transporti		Nuk ka	
Sistemi audio		Nuk ka	
Dhurata promocionale		Nuk ka	
Shenime: Ne takim me qytetaret ishte kryetari i partise zoti Kostaq Papa			

BASHKIA		Tirane	
Data dhe koha e vezhgimit		26/06/2019; Ora 19:30	
Vendosja e materialve propagandistike me shume se 5 metra nga zyra zgjedhore		JO	
Materialet e verejtura		Logo e partise	
Fotografi te marra		PO	
Tipi	Vendndodhja	Numri	Kostoja e parashikuar
Postera, logo	Tirane		
Partia/Kandidati		Partia Emigracioni Shqiptar	

Lloj i eventit	Takim i fushates elektorale	
Vendi dhe koha e fushates	Ambjent i jashtem i lokalit, Laprake	
Vendtakimi per fushaten zgjedhore	Tirane	Ora 19:30
Madhesia dhe kapaciteti i vendit	Pa percaktuar	
Numri i pjesmarresve	10-12	
Stafi organizues	Stafi i partise dhe vullnetare	
Pije dhe ushqim i ofruar	Nuk ka	
Argetim	Nuk ka	
Transporti	Nuk ka	
Sistemi audio	Nuk ka	
Dhurata promocionale	Nuk ka	
Shenime: Ne takim me qytetaret ishte kryetari i partise zoti Kostaq Papa		

BASHKIA		Kamez	
Data dhe koha e vezhgimit		26/06/2019; Ora 18:10	
Vendosja e materialve propagandistike me shume se 5 metra nga zyra zgjedhore		JO	
Materialet e verejtura		Logo e partise	
Fotografi te marra		PO	
Tipi	Vendndodhja	Numri	Kostoja e parashikuar
Postera, logo	Kamez		

Partia/Kandidati	Partia Emigracioni Shqiptar		
Lloj i eventit	Takim i fushates elektorale		
Vendi dhe koha e fushates	Ambjent i jashtem i lokalit, Kamez		
Vendtakimi per fushaten zgjedhore	Kamez	Ora 18:10	
Madhesia dhe kapaciteti i vendit	Pa percaktuar		
Numri i pjesmarresve	6-10		
Stafi organizues	Stafi i partise dhe vullnetare		
Pije dhe ushqim i ofruar	Nuk ka		
Argetim	Nuk ka		

Transporti	I te ftuarve, materialeve dhe zyrtareve te partise
Sistemi audio	Nuk ka
Dhurata promovionale	Nuk ka
Shenime: Ne takim me qytetaret ishte kryetari i partise zoti Kostaq Papa	

Partia Emigracionit Shqiptar pergatiti nje logo te partise qe u printua flete te vogla elektorale te tipit kartevizit, te cilat i shperndanin anetaret e kesaj partie te simpatizantet e partise apo te njohurit e tyre. Kjo eshte logo e shperndare:



### **Shkeljet e mundëshme të identifikuara të detyrimeve ligjore të fushatës zgjedhore**

Fushata zgjedhore e Partise se Emigracionit Shqiptar u zhvillua ne kushte te vecanta pasi nuk kishte mundesi per te organizuar takime elektorale apo tubime ne emer te saj. Kjo solli si rrjedhim qe as nuk mund te kryente shkelje te rregullave te fushates zgjedhore.

### **Zyrat elektorale**

Nuk jane konstatuar shkelje apo materiale te ndaluara.

### **Materiale të fushatës të ndaluara**

Nuk jane konstatuar shkelje apo materiale te ndaluara.

Ne kryem monitorimin e shpenzimeve të fushates zgjedhore 2019 të Partisë Emigracioni Shqiptar në përputhje me standardet profesionale dhe përgjegjësitë janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në kontratën e angazhimit. Ne jemi të pavarur nga pala përgjegjëse në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për angazhime të tilla, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca që kemi siguruar gjatë monitorimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për konkluzionin tonë, brenda një sigurie të kufizuar.

### **A. Konkluzionet:**

Në përputhje me objektivat e monitorimit që jënë dhënë në Udhëzimin e KQZ-së, Nr.2, datë 01.06.2017, e nr 8, datë 25.03.2009 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore”, i ndryshuar konkluzionet tona për secilën çështje janë si vijon:

Zbatimin e dispozitave ndaluese për financimin e fushatave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë Politike” i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017;

Mbështetur në punën tonë përshkruar në këtë raport dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr.1 ,datë 31.05.2017 të KQZ-së, i cili kërkon që:

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore lejohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera në një distancë jo më të madhe se 5 metra larg zyrës elektorale të subjektit zgjedhor,

Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se një zyrë elektorale për lagje qyteti ose fshat,une nuk kam evidentuar gjatë monitorimit raste të mosrespektimit të dispozitave ndaluese të cituara me sipër.

Dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës së subjektit zgjedhor;

Bazuar në punën tonë përshkruar në këtë raport dhe kriteret e vendosura nga legjislacioni zgjedhor, kontabël dhe tatimor për dokumentimin e shpenzimeve të subjekteve të treta në funksion të veprimtarive të fushatës, arrijme ne konkluzionin se: nuk ka pasur blerje dhe mallra me fatura

Transaksionet financiare të kryera për periudhën 3 muaj përpara dhe pas ditës së zgjedhjeve, nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim evidentimin e transaksioneve të pajustificuara dhe që mund të jenë përdorur për financim të paligjshëm të fushatës zgjedhore të një ose disa partive politike.

Bazuar në punën tonë përshkruar në këtë raport, ne nuk konstatuam burime të ardhurash në kundërshtim me kufizimet e legjislacionit zgjedhor.



## **B. PËRFUNDIMI**

Kryetari i Partise se Emigracionit Shqiptar zoti Kostaq Papa ka deklaruar se nuk ka perfituar fonde nga Buxheti i Shtetit per fushaten e zgjedhjeve 2019 apo fonde nga donatore persona fizike apo juridike. Nuk ka kryer shpenzime pasi ka komunikuar me ata zgjedhes qe i njej personalisht, nuk ka hapur llogari bankare ne funksion te fushates zgjedhore per zgjedhjen e organeve te qeverisjes vendore te dates 30 qeshor 2019.

Edhe nga monitorimi i kryer gjate fushates zgjedhore qe kam raportuar prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve nuk kam verejtur parregullsisepse fushata nuk kishte takime me shume zgjedhes apo zyra elektorale dhe si rrjedhim nuk kishte as shpenzime te matshme per te cillat mund te kryhen analiza.

AUDITUES LIGJOR

Eleda Dhima

Lagjja “Xhevdet Nepravishata” Lushnje

Cel: 069 40 98 121

E-mail: eledadh@yahoo.it